

ANEKSI 7

Fondi për Digat

1. **Fondi për Digat** është një mekanizëm financiar që mbështet **rehabilitimin/rikonstrukcionin e digave të rezervuarëve**, duke mbështetur politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit të fatkeqësive natyrore.
2. Për vitin 2024, Fondi për Digat është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2024 në programin "Emergjencat Civile", në Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Vlerësimi i projekteve që përfshim, studimin dhe projektin e zbatimit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.
4. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore kryesohet nga Drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtarë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore, dhe bashkëpunon edhe me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.
5. Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve për rehabilitimin dhe rikonstrukcionin e digave të rezervuarëve** si dhe vlerësimin e projekteve.
6. Sekretariati teknik për Fondin për Digat ngrihet pranë AKMC dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.
7. Projektet që përfitojnë financimin vendosen në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në përputhje me ecurinë e tyre, Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime mes projekteve të Fondit për Digat sipas procedurave të miratuara për investimet publike.
8. Thirrjet për aplikim në Fondin për Digat për vitin buxhetor 2024, fillojnë nga nëntori 2023 dhe deri në 28 shkurt 2024.
9. Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 mars 2024.
10. Këshilli i Ministrave miraton projektet fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 1 prill 2024.
11. Fondi për Digat nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.
12. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.